



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

---

Numri i lëndës: 2022:267316  
Datë: 26.04.2024  
Numri i dokumentit: 05629353

**C-IV-16-0139**

Paditësi: N B të cilin e përfaqëson avokati B I. Prishtina.  
Kundër

E paditur: NSH PMN „Sharri”, përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit ( AKP ) në Prishtinë, rr. “Driton Hoxha ” nr. 55.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimi, me gjyqtarin Hasim Sogojeva, me 26 prill 2024, mori këtë :

**A K T V E N D I M**

**Konsiderohet e Tërhequr, Ankesa/Kërkesa e paditësit, : N B kundër Vendimit të AKP/AL për NSH “Sharr”, GJI042-3949, dt. 14.05.2014.**

**Rrethanat Faktike dhe Procedurale**

Me 20 janar 2016, paditësi në DHPGJS, është parashtruar nga përfaqësuesi i paditëses parashtresa për plotësimin, precizimin dhe ndarjen e ankesës-padisë kolektive, lidhur me ankesën e paditësit kundër të paditurit në lidhje me anulimin e vendimit të Autoritetit Likuidues të NSH PMN „SHARR” GJI042-3949, të dt. 14.05.2014, si dhe kërkesa për kompensimin për shkak të ndërprerjes së parakohshme të mardhenjës së punës në shumë prej 3.973.55 euro në emër të 7 pagave, se bashku me interesin prej 10%, dhe shpenzimet e procedurës.

Kësaj ankese si prova i ka bashkëngjitur:

- *Kopjen e Vendimit GJI042-3949, të dt. 14.05.2014*
- *Njoftimin për ndërprerjen e mardhenjës së punës të lëshuar nga AKP-ja..*

Më dt. 09 shkurt 2016 AKP- ja, përmes përfaqësuesit ka dorëzuar parashtresën e mbrojtjes ndaj pretendimeve të paditësit kundër Vendimit GJI 042- 3849 të Autoritetit të Likuidimit të NSH PMN “Sharr ” dhe në kërkesën për kompensimin kompensimin për shkak të ndërprerjes së parakohshme të kontratës së punës. Me të cilën kërkon nga gjykata të hidhet ankesa si e pa

bazuar dhe të vërtetoi ( lërë në fuqi ) Vendimin e Autoritetit të Likuidimit.

AKP në parashtresë të mbrojtjes është deklaruar se NSH ka hyrë në procedurë të likuidimit më dt. 22 mars 2011, me dt. 01.06.2011 ankuesi ka deponuar kërkesën në AKP, përmes të cilës ka kërkuar dëmshpërblim për ndërprerjen e parakohshme të mardhenjës së punës. AKP deklaroi se AL ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore gjithashtu janë zbatuar saktësisht, dhe po ashtu ka dhënë argumente për ta vërtetuar papranueshmërinë e Ankesës/Padisë, si të pabazueshmerin e saj. Dhe kërkon nga Gjykata që ta Refuzoj si të papranueshme dhe/ose të pabazuar ankesën/padinë e paditësit. Të lër në fuqi Vendimin e AL-së.

Me 29 shkurt 2016, i autorizuari i paditësit dorëzoi përgjigjen në mbrojtje të AKP-së duke kundërshtuar pretendimet e AL-së, padija-ankesa është ushtruar jashtë afatit, nuk qëndron pasi që sipas paditësit afati duhet të kalkulohet prej datës kur është dorëzuar padija në Gjykatë e jo kur është ndarë padia grupore. Lidhur me meritat e kërkesëpadin, paditësi deklaroi se pretendimet e AL-së, se paditësi është punësuar tek privatizuesi, ai e ka humbur të drejtën e tij për dëmshpërblim për shkak të ndërprerjes së parakohshme të mardhenjës së punës në NSH. Sipas paditësit ky pretendim nuk ka mbështetje në asnjë dispozitë ligjore, pasi që të drejtën e punëtorëve për dëmshpërblim për shkak të ndërprerjes së mardhenjës së punës e garanton neni 6.3 i ligjit për AKP-në si dhe neni 76.7 i ligjit të Punës, ndërsa neni 40 i shtojcës së ligjit të AKP-së përcakton prioritetet e kërkesave.

Më dt. 16 mars 2017, AKP-ja dorëzoi kundërpërgjigjen me të cilën është deklaruar lidhur me kompetencën e bashkimit të lëndëve kjo kompetence ekskluzivisht është e Gjykatës, edhe në baza të nenit 33 i shtojcës së ligjit nr. 04/L-033, shprehimisht ja njëj ketë kompetencë Gjykatës. AKP deklaroi se paditësi në përgjigjen në mbrojtje i ka përsëritur të njëjtat argumente si në Ankesë duke mos ofruar asnjë interpretoim shtesë. Me çka AKP, mbetet pranë parashtresës së mbrojtjes, ndërsa me këtë parashtresë ka kundërshtuar nga Gjykata të refuzoj ankesën si të pabazuar dhe të vërtetoj Vendimin e AL-së.

Më 09 gusht 2023, DHPGJS ka lëshuar Urdhër C-IV-16-0139 për pagesën e taksës gjyqësore për paditësin, me të cilën ka kërkuar të paguhet taks gjyqësore. Paditësi është njoftuar për pasojën juridike të mos veprimit.

Më 11 gusht 2023, Urdhri për pagesën e taksës gjyqësore, është pranuar nga përfaqësuesi i paditësit/ankuesit, siç shihet në vërtetim mbi dorëzimin e dokumentit.

### **Arsyetimi ligjor**

**Ankesa/ kërkesa e paditësit, konsiderohet e tërhequr.**

**Paditësi nuk e ka paguar taksen gjyqësore .**

Bazuar në nenin 5.5.2 të Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2017, hyrë në fuqi më 01 maj 2017, për aplikimin e njëjtë të taksave gjyqësore, paditëses i kërkohet që brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga të shërbyerit dhe pranimit i urdhrit të gjykatës për të ia dorëzuar Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës vërtetimin dhe faturën e pagesës të shumës së caktuar që duhet paguar ose që t'i dorëzojë gjykatës prova në lidhje me faktin se ai është i liruar nga pagesa për

arsye se është përfitues i ndihmës sociale nga ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ose Ndhimës Ligjore nga Zyra për Ndhimë Juridike.

Udhëzimi Administrativ nr. 01/2017, për unifikimin e tarifave gjyqësore, neni 5 paragrafi 5.1, parashikon detyrimin e të gjithë atyre që i drejtohen Gjykatës për të paguar taksat gjyqësore për procedimin në shumën e duhur, ashtu që sipas neni 13 të Udhëzimit Administrativë nr. 01/2017, për unifikimin e taksave gjyqësore është caktuar taksa në lartësi 20 €.

Për më tepër, Udhëzimi Administrativ nr. 01/2017, neni 5.5.2 parasheh që, "nëse pas njoftimit, pala nuk i paguan taksat gjyqësore, sipas nenit 5.1 të këtij udhëzimi, gjyqtari i caktuar për çështjen, do të aplikojë nenin 253, paragrafi 5 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore dhe si pasojë padia do të konsiderohet e tërhequr.

Paditësi/ankuesi përmes Urdhrit, dt. 09 gusht 2023, të cilin e ka pranuar më dt. 11.08.2023, u informua për faktin se në bazë të nenit të lartpërmendur të Udhëzimit Administrativ, në rast të mos pagesës së taksës, Gjykata do të marrë një vendim duke e konsideruar të tërhequr ankesën. Meqenëse paditësi, deri në ditën e marrjes së vendimit nuk e ka dorëzuar dëshminë për pagesën e taksës gjyqësore, gjykata në kuptim të dispozitës së nenit 253. 5 të LPK-së, ankesën/ kërkesën e paditësit e konsideroi të tërhequr.

### **Këshillë Juridike:**

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë, me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditësh, nga pranimi i këtij aktvendimi.

Gjyqtar,  
Hasim Sogojeva